

AKT-THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “NODE”

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE, KOHEZGJATJA.

Ne baze te Ligjit nr.7512, date 10.08.1991, dhe ndryshimeve “Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit” dhe ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” si dhe te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” dhe statutit te shoqerise, me vullnetin e tij te lire shprehur ne nenshkrimin e ketij akti, ortaku: **Zoti Eridon Hysendhima**, lindur me 12.10.1984, banues ne Tirane , me karte identiteti id: I41012046M, me shtetesi dhe kombesi shqiptare ka hartuar, si me poshte vijon ,aktin e themelimit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht me Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “**Per tregtaret dhe shoqerite tregtare**”, te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise, si dhe dispozitat e Statutit te shoqerise qe i bashkengjiten ketij Akti Themelimi.

Emertimi i shoqerise eshte “NODE” SH.P.K.

SELIA E SHOQERISE.

Selia e shoqerise e caktuar ne :

Hamdi Garunja; Nd. 19; H. 3; Ap. 10; Farke; Sauk; 1045 TIRANE!

Ajo mund te transferohet ne cdo vend tjeter te rrethit, ose mund te transferohet kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise ne baze te nje vendimi te asamblese se pergjithshme te jashtezakonshme te ortakeve. Ajo me vendim te asamblese se ortakeve mund te hape dhe mbylle filiale, dege ose zyra perfaqesimi ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise.

JETEGJATESIA E SHOQERISE

Kohezgjatja e shoqerise eshte caktuar 50 (pesedhete vjet) duke filluar nga data e rregjistrimit ne regjistrin tregtar. Shkurtimi i kesaj kohezgjatje ne rastin e nje prishje te pershpejtuar ose zgjatja e afatit behen me vendim te asamblese se pergjithshme te jashtezakonshme te ortakeve.

OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqeria ka per objekt:

Ofrimin e sherbimeve ne fushen e teknologjise se informacionit, sherbimeve te sigurise teknologjike, kontroll cilesie si dhe zbatimi ne projekte ne fushen e teknologjise se informacionit, kontroll cilesie ne kodim dhe implementim te sistemeve, konsultimeve,

publikimeve desktop 'DTP sherbime', krijimeve teknologjike dhe ofrimit te konsulences tregtare.

1. Zhvillimin dhe mirembajtjen e programeve kompjuterike dhe rishitjen e programeve kompjuterike.
2. Rekrutimin dhe trajnimin e burimeve njerezore. Ofrimin e sherbimeve te menaxhimit te projekteve per palet e treta.
3. Venien ne dispozicion te ekspertizave informatike dhe konsulences per biznesin. Ofrimin e sherbimit te marketingut me pakice ne kuader te ofrimit te disa sherbimeve per palet e treta, siç eshte konsulenca.
4. Kur eshte e nevojshme, per te realizuar qellimin e aktiviteteve te saj, shoqeria mund te hyje ne partneritet me personat fizike ose juridike vendas ose te huaj, te marre aksione, te bleje stoqet e shoqerive te themeluara duke marre persiper edhe aktivitete te shoqerive te tjera si edhe te siper marrjeve individuale.
5. Ofrimin e sherbimeve te konsulences ne fushen e biznesit, menaxhimit, taksave, sherbimeve IT, etj.
6. Organizimin e praktikës profesionale ne mesim dhe zhvillim, posaçerisht ne lidhje me kryerjen e aktiviteteve dhe sherbimeve te Teknologjise Informative.
7. Vendosjen ne dispozicion te çdo instrumenti tregtar, industrial dhe financiar, ne zbatimin e objektit te shoqerise, perveç aktiviteteve qe nuk jane te parashikuara me ligj.
8. Realizimin dhe ofrimin e cdo do aktiviteti qe eshte brenda fusheveprimit te shoqerise qe ka lidhje me objektin e aktivitetit te shoqerise dhe eshte ne funksion te ketij objekti. Shoqeria ushtron aktivitetin ne perputhje me te gjitha ligjet dhe rregulloret perkatese ne fuqi. Shoqeria funksionon sipas standardeve me te larta dhe praktikave me te mira etike sipas ligjit.

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali aksionar i nenshkruar i papaguar eshte caktuar ne vlere prej 100.000 (njeqindmije) leke dhe zoterohet nga ortakut i vetem Eridon Hysendhima, 100%.

Ai eshte i ndare ne 1 pjese me vlere nominale 100,000 leke.

Kontributi (kapitali aksionar) i ortakut eshte ne para (leke).

Personi qe firmos kete akt pasi ka mare dijeni per kete certificate, nje kopjo ekzakthe e se ciles I eshte paraqitur atij, deklaron se shuma e mesiperme eshte ne perputhje me ate qe shenohet ne certificate dhe se ato konfirmojne nenshkrimet e pjeseve te kapitalit themeltar ne perputhje me shumen respective te derdhur.

ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqerise jane:

-Asambleja e Ortakeve.

-Administratori.

Asambleja e Ortakeve eshte ogani me I larte I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

NODE SH.P.K.

Nepermjet ketij emerohet administratori I shoqerise Zotit Eridon Hysendhima, te cilit I jepen te gjitha kompetencat, qe ai i pranon, per te kryer te gjitha formalitetet per krijimin e shoqerise, parashikuar sipas ligjit ne fuqi.

Ortaket dhe administratori ushtrojne te gjitha kompetencat, te drejttat dhe detyrimet per organizimin dhe drejtimin e shoqerise, te cilat parashikohen nga ky statut, akti i themelimit dhe legjislacioni shqiptar, per te vepruar ne emer dhe per llogari te shoqerise, ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe ky statut ja njohin shprehimisht ortakeve.

Kompetencat e administratorit jane:

- Organizimi i veprimtarise se shoqerise per te plotesuar programin qe buron nga objekti i veprimtarise se saj.

- Administrimi i pergjithshem i shoqerise.

- Perfaqeson shoqerine para autoriteteve gjyqesore, te arbitrimin dhe administrative.

- Administron pasurine dhe aktivet financiare te shoqerise, brenda kufijeve te caktuar nga ortaket.

- Te leshoje dokumente zyrtare ne emer te shoqerise per te punesuarit e shoqerise dhe ne pergjithesi per palet e treta.

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht viti I pare financiar kur do te nise veprimtaria e shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor.

Shoqeria e fillon aktivitetin ne momentin e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit Tirane.

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me ane te kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes, zbatohen dispozitat e Kodit te Punes.

Ky akt-themelimi eshte hartuar ne Tirane , me 19.05.2023, ne kater ekzemplare duke patur te gjitha tekstet fuqi te barabarte.

**FIRMOSUR NGA
ORTAKU**